

Nr. 384 prot.

Tiranë, 18 / 02 /2026

Nr. 51 prot.

Tiranë, 18/02 /2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

PËR

KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI



ROBERT GAJDA
KOMISIONER
TIRANË

PËR

AGJENCINË KOMBËTARE TË RINISË

SARA BODO

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË
TIRANË

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Dhe

Agjencisë Kombëtare të Rinisë

Lidhur sot më ___/02/2026, në Tiranë ndërmjet:

Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (këtej e tutje e cilësuar si KMD), përfaqësuar nga Z. Robert Gajda, me adresë Rruga e Durrësit, nr.27, Tiranë, dhe

Agjencia Kombëtare e Rinisë (këtu dhe në vijim referuar si “AKR”), person juridik publik, identifikuar me NIPT L42408451A, me adresë Rr. “Naim Frashëri” Nr. 37, 1000, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. Sara Bodo.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë, kanë një eksperiencë dhe përvojë të gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dëshirojnë që të çojnë përpara bashkëpunimin e ndërsjellët ndërmjet tyre në këtë fushë, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për sa më poshtë:

Palët duke shprehur vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, deklaruan se bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, në zbatim të kërkesave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 1 BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje hartohet në bazë të Kodit Civil në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, i ndryshuar, Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 02.09.2020, “Për Mënyrën e Krijimit, të Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 692 datë 26 Tetor 2022 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029” dhe legjislacionit të aplikueshëm në fuqi.

NENI 2 OBJEKTI I MARRËVESHJES

2.1 Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi midis AKR-së dhe KMD me synim parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, promovimin e parimit të barazisë dhe trajtimit të barabartë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të të rinjve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmes koordinimit të veprimtarive të përbashkëta informuese, edukuese dhe institucionale.

Neni 3 QËLLIMI

3.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e çdo forme diskriminimi ndaj të rinjve, promovimin e barazisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe integrimin e parimit të mosdiskriminimit në politikat, programet dhe veprimtaritë rinore.

Neni 4 FUSHA E ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja do të zbatohet midis Palëve të lartëpërmendura në fushën që përmban kjo Marrëveshje për të përmbushur qëllimin e saj.

Kjo Marrëveshje do të konsistojë në:

- a) Bashkëpunim për identifikimin e formave të diskriminimit që prekin të rinjtë (gjinore, etnike, aftësi e kufizuar, orientim seksual, status social, etj.
- b) Nisma për mbrojtjen e të rinjve nga diskriminimi në arsim, punësim dhe shërbime publike.
- c) Përfshirja e të rinjve në nisma kundër diskriminimit.
- d) Konsultim dhe bashkëpunim për hartimin e politikave dhe programeve rinore gjithëpërfshirëse.
- e) Integrimi i parimit të mosdiskriminimit në strategjitë dhe planet e veprimit për rininë.

- f) Trajnime për stafin e AKR-së mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe referimin e rasteve të diskriminimit që prekin të rinjtë.
- g) Studime të përbashkëta mbi situatën e diskriminimit të rinjtë.

Neni 5

KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

- 5.1** Palët angazhohen të mbledhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj.
- 5.2** Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.
- 5.3** Secila nga Palët cakton një person kontakti, të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin ato me gojë ose me shkrim, elektronike dhe të shtypura në letër. Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes, personat e kontaktit janë si më poshtë:

Për AKR: **Znj. Krisi Kllapi**
Pozicioni: Përgjegjëse e Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Projekteve të Huaja.
E-mail: krisi.kllapi@rinia.gov.al
Nr. Telefonit: 069 99 26 867

Për KMD: **Znj. Armela Ibraliu**
Pozicioni: Specialiste në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave.
E-mail: armela.ibraliu@kmd.al
Nr. Telefonit: 0698442854

- 5.4** Në rast ndryshimi të personave të caktuar për sa cituar, Pala e cila përfaqësohet nga Znj. Armela Ibraliu, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e përfaqësuesit të ri të kontaktit.

NENI 6

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

- 6.1 Palët garantojnë se të gjitha të dhënat personale të zbuluara në bazë të marrëveshjeve të lidhura do të përpunohen në përputhje me të gjitha parimet dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 27 Prill 2016 mbi Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale dhe Lëvizjes së Lirë të këtyre të dhënave dhe shfrytëzimin e Direktivës 95/46 KE (rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tyre sipas Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave), Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe legjislacionit relevant.
- 6.2 Të dyja palët pranojnë të ruajnë informacionin konfidencial dhe të sigurojnë mbrojtjen e tij, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Informacioni konfidencial nuk do të ndahet me palë të treta pa lejen e shkruar të palës tjetër.

NENI 7

KOHËZGJATJA

- 7.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare.
- 7.2 Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 7.3 Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve.
- 7.4 Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim palën tjetër.
- 7.5 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë dhe secila palë mban një kopje origjinale.

NENI 8

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 8.1** Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje fillimisht Palët do ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt do t'i drejtohen gjykatës kompetente.
- 8.2** Termat dhe kushtet e përcaktuara këtu përbëjnë marrëveshjen e plotë midis palëve dhe mund të ndryshohen ose shtohen vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Marrëveshje.
- 8.3** Kjo marrëveshje mund të ndërpritet nga secila palë me njoftim të paktën 30 ditë përpara.

NENI 9

DISPOZITA E FUNDIT

- 9.1** Marrëveshja zëvendëson çdo lloj korrespondence të mëparshme të mbajtur midis palëve. Kjo Marrëveshje mbizotëron mbi çdo term ose detyrim tjetër ose dokument tjetër që është pranuar nga palët kontraktuese.
- 9.2** Kontrata jo formale janë të vlefshme vetëm nëse materializohen në formë të shkruar. Ky rregull duhet të ndiqet edhe në rastin e ndryshimeve ose modifikimeve pasuese të cilat nuk janë miratuar nga përfaqësuesit ligjorë ose nga persona të legjitimuar të përfaqësojnë palën përkatëse kontraktuese.
- 9.3** Mosekzekutimi i ndonjë të drejte të njohur nga Marrëveshja nuk do të konsiderohet si heqje dore nga kjo e fundit.
- 9.4** Në rast se ndonjë nga dispozitat e Marrëveshjes ose pjesë e saj është ose shpallet e pavlefshme, nuk do të cenohet vlefshmëria e dispozitave të tjera.
- 9.5** Anekset që i bashkëngjiten Marrëveshjes përbëjnë një pjesë integrale të saj.

NENI 10
HYRJA NË FUQI

10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi më datë 18.02.2026 dhe përpilohet në katër kopje, në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të njëjtë secila, nga dy për secilën Palë.

PËR

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

ROBERT GAJDA

KOMISIONER


PËR

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

SARA BODO

DREJTOR I PËRGJITHSHËM


